

Vendim nr. 296 datë 10.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 10.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 36 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ALBAN RULI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-904, datë 21.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i lidhur me rekursin ndaj vendimit nr. 2000 (30-2023-7621), datë 01.11.2023 të Gjykatës së Apelit së Juridiksionit të Përgjithshëm, i lidhur me ankimin ndaj vendimit nr. 2223, datë 02.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes/privimit të lirisë në caktimin në mënyrë të papërshtatshme dhe joproporcionale të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, në përputhje me parashikimet detyruese të Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Kodit të Procedurës Penale, vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimeve të Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë, në respektim të të drejtave të patjetërsueshme themelore të njeriut,

në përputhje me legjislacionin penal në fuqi dhe procedurën penale të konsoliduar ndër vite.

Konstatimi i statusit të viktimës të kërkuarit gjatë procesit gjyqësor si pasojë dhe rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkeljes për shkak të vendimeve nr. 2223, datë 02.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr. 2000 (30-2023-7621) datë 01.11.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 00-2024-904, datë 21.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Rehabilitimi dhe zhdëmtimi në përputhje me ligjin, pasi dëmi/dëmtimi është shkaktuar/ka ardhur për shkak të vendimeve nr. 2223, datë 02.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr. 2000 (30-2023-7621) datë 01.11.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 00-2024-904, datë 21.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, me një tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 17, 18, 30, 33, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, 8, 13 dhe 34 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 2 i Protokollit nr. 1 të saj; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; nenet 27, 49, 50, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) ka regjistruar procedimin penal nr. 8586, datë 25.11.2022 (*procedimi penal nr. 8586/2022*) për veprat penale “Vjedhja”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 134, paragrafi 3, 248 dhe 320 të Kodit Penal (*KP*). Në datën 05.01.2023 Prokuroria e Tiranës ka urdhëruar shënimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe të emrit të kërkuesit, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, duke iu referuar veprimeve të tij si përmbaues gjyqësor privat dhe përfaqësues i Zyrës Përmbaimore “ARB”, veprime të cilat, së bashku me ato të disa personave të tjerë, dyshohej se i kanë sjellë dëm të rëndë buxhetit të shtetit. Në kuadër të këtij procedimi penal kërkuesi u është nënshtruar masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues që i kanë kufizuar lirinë personale, fillimisht asaj të “Arrestit në burg” dhe më pas të “Arrestit në shtëpi”, ku për sa i përket vijimit të zbatimit të kësaj të fundit, ai ka kundërshtuar vendimet e dhëna gjatë procesit gjyqësor të vënë në lëvizje prej tij.

2. Fillimisht, gjatë hetimit paraprak, me kërkesë të prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 30 regj. themeltar, datë 11.01.2023, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Masa e sigurimit është zbatuar dhe pas marrjes në pyetje të kërkuesit, ajo gjykatë, me vendimin nr. 30/1 akti, datë 13.01.2023, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të saj. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 9, datë 02.02.2023, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i KPP-së.

3. Ndërsa hetimet paraprake vijonin, në datën 30.05.2023 kërkuesi ka paraqitur në gjykatë një kërkesë për revokimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Me vendimin nr. 1170 regj. themeltar, datë 29.06.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. (30-2023-4123) 1109, datë 18.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Kurse për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1729, datë 31.10.2023, ka vendosur mospranimin e tij.

4. Në datën 13.07.2023 Prokuroria e Tiranës ka paraqitur në gjykatë kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes së kërkuesit për akuzat e kryerjes së veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”

dhe “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”. Gjatë këtij procesi, në datën 28.09.2023 kërkuesi ka paraqitur një kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, gjyqtari i seancës paraprake, me vendimin nr. 2223, datë 28.09.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit. Mbi ankimin e këtij të fundit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 2000 (30-2023-7621), datë 01.11.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjykatës së shkallës së parë. Kurse për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-904, datë 21.05.2024, ka vendosur mospranimin e tij.

5. Ndërkohë, pasi çështja e kërkuesit ka kaluar për gjykim, në përfundim të tij Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3006, datë 15.12.2023, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, duke e dënuar përfundimisht me 1 vit e 2 muaj burgim, vendim ndaj të cilit kërkuesi ka paraqitur ankim.

6. Ndërsa çështja penale e themelit ishte në pritje për t’u gjykuar në apel, në datën 27.02.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në gjykatë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, mbi shkakun se kishte vuajtur dënimin me burgim të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 521, datë 29.02.2024. Në vijim të gjykimit të çështjes së themelit, kjo e fundit, me vendimin nr. 692, datë 28.03.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke deklaruar kërkuesin të pafajshëm për veprat penale që akuzohej.

7. Në datën 04.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në procesin e vënë në lëvizje me kërkesën e tij të datës 28.09.2023, për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi” (*shih paragrafin 4 të këtij vendimi*).

II

Pretendimet e kërkuesit

8. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

- 8.1. Është cenuar *liria personale*, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, për shkak të shkeljes së të drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:
- 8.1.1. *Parimit të gjykatës së paanshme*, pasi trupi gjykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin nr. 00-2024-904, datë 21.05.2024 për mospranimin e rekursit të tij në kuadër të procesit për zëvendësim të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, është i njëjtë me atë të kolegjit që ka dhënë vendimin nr. 00-2023-1729, datë 31.10.2023 për mospranimin e rekursit të tij në kuadër të procesit për revokimin e kësaj mase sigurimi personale. Referuar neni 17, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së, trupi gjykues kishte detyrimin për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes së dytë për sa kohë ndodhej para dy çështjeve me të njëjtat palë dhe objekt, çështje për të cilën ai trup gjykues ishte shprehur më parë. Parimi i procesit të drejtë ka në thelb garancinë për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, e cila duhet të jetë e tillë jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur.
- 8.1.2. *Parimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale*, pasi gjatë shqyrtimit të kërkesës së kërkuesit për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, prokurori u shpreh dakord për pranimin e kërkesës dhe ndryshimin e masës së sigurimit personal, ndaj gjykata e shkallës së parë duhet të pranonte kërkesën e kërkuesit për sa kohë edhe vetë organi procedues konsideroi të përshtatshme zbutjen e masës së sigurimit personal.
- 8.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi kërkuesi ka qenë dhe mbetet në pozita jo të barabarta me shtetas të tjerë, ndërsa pozita e tij në lidhje me lirinë substanciale është rënduar pa një proces të rregullt ligjor.
- 8.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e proporcionalitetit*, pasi kufizimi i lirisë së kërkuesit për periudhën 11.01.2023 - 02.02.2023 nën masën e sigurimit “Arrest në burg” dhe për periudhën 02.02.2023 - 29.02.2024 nën masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, përbën kufizim të pajustificuar dhe joproporcional në kuptim të neni 17 të Kushtetutës dhe neni 5 të KEDNJ-së. Gjykatat e zakonshme nuk kanë diskutuar për proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, duke mos treguar arsye të duhura dhe të mjaftueshme që mbështesin vendimet e

tyre, por kanë përdorur një arsyetim abstrakt dhe stereotip, i cili është vlerësuar më se një herë si i papërshtatshëm nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*). Gjykatat nuk kanë konsideruar vendimin unifikues nr. 7/2011 të Gjykatës së Lartë në lidhje me argumentimin e nevojave të sigurimit, vendimin nr. 103/2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit masa e sigurimit nuk është masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një veprë penale, por një kufizim i përkohshëm dhe shkalla e tij varet nga nevojat konkrete të hetimit, si dhe vendimin unifikues nr. 3/2002 të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit masat e sigurimit mund të caktohen edhe pa u marrë personi më parë si i pandehur, me kusht që të jetë vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet dhe për të drejtat e tij, ndërkohë që në rastin konkret, për akuzën e dytë, kërkuesit nuk i është lënë mundësia dhe koha për t'u mbrojtur në respektim të nenit 31 të Kushtetutës. Gjykatat e zakonshme nuk kanë konsideruar as nenin 49 të KP-së në lidhje me rrethanat lehtësuese në favor të kërkuesit, ndërsa në dosjen gjyqësore gjenden një sërë dokumentesh shkresore të cilat duhet të ishin analizuar dhe marrë në konsideratë për të arritur në përfundime në lidhje me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e caktimit të masës së sigurimit ndaj tij. Gjykatat e zakonshme kanë dështuar të tregojnë detyrimet e lindura nga KEDNJ-ja, më së paku të atyre që lidhen me arsyet relevante dhe të mjaftueshme që justifikojnë masën “Arresti në shtëpi” ndaj kërkuesit, si dhe për faktet specifike dhe rrethanat personale të kërkuesit që justifikonin mbajtjen e tij nën këtë masë sigurimi.

- 8.2. Është cenuar *e drejta e pronës private*, për shkak të fillimit dhe vazhdimit të paligjshëm të procedimit penal përkundrejt organizimit të kërkuesit si person juridik në veprimtarinë e tij si përmbarues gjyqësor privat, ndërsa për shkak të procedimit penal, me urdhrin nr. 212, datë 13.03.2023 të ministrit të Drejtësisë është vendosur pezullimi i përkohshëm i veprimtarisë ekonomike të kërkuesit, pezullim që ka vijuar deri në datën 19.04.2024, duke mos poseduar dhe disponuar dot vijimësi e vazhdueshmëri të aktivitetit ekonomik.
- 8.3. Konstatimi i shkeljeve kushtetuese në procesin gjyqësor të kundërshtuar është garanci për rehabilitimin e kërkuesit dhe eliminimin e statusit të viktimës, për sa kohë ai vijon ta ruajë këtë status, ndërsa aktiviteti i tij ekonomik është dëmtuar duke rezultuar me humbje në vitin ushtrimor 2023, përveçse ai dhe familjarët e tij kanë

pësuar dëmtime në shëndet, ndaj për shkeljet kushtetuese atij duhet t'i akordohet një dëmshpërblim i arsyeshëm në përputhje me nenin 44 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” (ligji nr. 8510/1999), me qëllim që ankimi në Gjykatë të konsiderohet si mjet juridik efektiv.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në rastin në shqyrtim, kërkuari ka kundërshtuar procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për kërkesën e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Gjatë zhvillimit të këtij procesi (përfunduar në datën 21.05.2024), në procesin e themelit gjykata e shkallës së parë (në datën 15.12.2023) e ka deklaruar fajtor kërkuarin. Ky vendim është ndryshuar nga gjykata e apelit (në datën 28.03.2024), e cila e ka deklaruar atë të pafajshëm. Ndërsa çështja penale e themelit ishte në pritje për t’u gjykuar në apel, në datën 27.02.2024 kërkuari ka paraqitur kërkesë në gjykatë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, mbi shkakun se kishte vuajtur dënimin me burgim të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 521, datë 29.02.2024. Për zbatimin e vendimit është lëshuar urdhër ekzekutimi nga prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kjo do të thotë se në kohën e shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues individual të kërkuarit, masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” nuk ka pasur më efekte ndaj tij.

11. Gjykata ka pohuar se në rastin e kufizimit të lirisë personale si pasojë e zbatimit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues edhe nëse në kohën e shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë ai nuk ndodhet më në kushtet e kufizimit të lirisë (*shih vendimin nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione personae*, Gjykata evidenton se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka ngritur pretendime për proporcionalitetin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, vendosur ndaj tij nga gjykata e shkallës së parë dhe e zbatuar për periudhën 11.01.2023 - 02.02.2023. Kolegji vëren se proporcionaliteti i kësaj mase është bërë objekt vlerësimi nga gjykata e apelit, e cila ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm nga ajo të nevojave të sigurimit, masë e cila është e zbatuar menjëherë. Në këto kushte, ndërsa pretendimet e kërkuesit në lidhje me proporcionalitetin e masës “Arresti në burg” janë marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila, në ushtrim të kontrollit të saj subsidiar ndaj vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, i ka vlerësuar ato të bazuara, duke konstatuar shkelje nga kjo e fundit, Kolegji vlerëson se, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për këto pretendime, për shkak se pasojat e drejtpërdrejta dhe reale të masës “Arresti në burg” nuk ekzistojnë më, pasi janë riparuar brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm. Ndërsa lidhur me pretendimet për masën “Arresti në shtëpi”, të dhënë nga gjykata e apelit edhe pse ajo nuk është më në fuqi në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, bazuar në jurisprudencën e lartpërmendur dhe në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në shtëpi, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit

131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për kërkesën e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, ndaj në këto rrethana vendimi që ka përmbyllur procesin gjyqësor për zëvendësimin e kësaj mase konsiderohet përfundimtar për efektet e gjykimit kushtetues.

15. Për sa i takon shterimit në substancë të mjeteve të zakonshme të ankimit, vërehet se pretendimi për cenimin e *parimit të gjykatës së paanshme*, pasi trupi gjykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin nr. 00-2024-904, datë 21.05.2024 për mospranimin e rekursit të tij në procesin për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” është i njëjtë me atë kolegjit që ka dhënë vendimin nr. 00-2023-1729, datë 31.10.2023 për mospranimin e rekursit të tij në procesin për revokimin e kësaj mase sigurimi personal, nuk është ngritur nga kërkuesi përpara asaj gjykate sipas procedurës standarde, pavarësisht se në kohën e shqyrtimit të rekursit (datë 21.05.2024) ai ishte në dijeni për përbërjen e trupit gjykues, sikundër edhe për faktin se ai trup gjykues kishte shqyrtuar më parë rekursin e tij në procesin për revokimin e masës (datë 31.10.2023). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për këtë pretendim. Ndërsa për pretendimet e tjera, kërkuesi nuk ka mjete të tjera përveç ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 21.05.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 04.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

17. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar kërkesën e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, me pretendimin se gjykatat i kanë cenuar lirinë personale për shkak të mosgarantimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e

proporcionalitetit, si dhe të drejtën e pronës private dhe të drejtën për rehabilitim të tij dhe dëmshpërblim të arsyeshëm.

18. Për sa i përket pretendimit se konstatimi i shkeljeve kushtetuese në procesin gjyqësor të kundërshtuar është garanci për *rehabilitimin e kërkuarit* dhe eliminimin e statusit të viktimës, dhe akordimin e një *dëmshpërblim i arsyeshëm*, në përputhje me nenin 44 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 8510/1999, Kolegji vlerëson se bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ai nuk bën pjesë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj kërkuari nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me të (*shih vendimet nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 39, datë 09.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale*, kërkuari ka argumentuar se gjatë shqyrtimit të kërkesës së tij për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” prokurori është shprehur dakord për pranimin e saj dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndaj gjykata e shkallës së parë sipas nenit 260, pikat 1, 2 dhe 4, të KP-së duhet të pranonte atë.

20. Kolegji vëren se neni 260, pika 4, i KPP-së parashikon se kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Në rastin në shqyrtim, gjykata e shkallës së parë, bazuar në nenin 260, pika 2, të KPP-së, që parashikon zëvendësim të masës së sigurimit me një masë më të lehtë, kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dëmit, ka vlerësuar se nuk ka ndryshim të rrethanave për sa i përket faktit penal për të cilin dyshohet kërkuari, si dhe ekziston rreziku i largimit të tij, ndërkohë që paraqet rrezikshmëri shoqërore, pasi është duke u gjykuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” që parashikon dënim me burgim deri në 7 vjet. Po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar se nuk ka asnjë bazë apo garanci ligjore për të zëvendësuar masën e sigurimit dhe se qëndrimi i saj është në përputhje me vendimin unifikues nr.7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili përcakton se gjykata ka diskrecion të gjerë për të vendosur. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se pavarësisht kërkesave të prokurorit, është atribut i gjykatës të vendosë në vlerësim të fakteve dhe provave të çështjes konkrete. Prandaj, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkuarit, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të ligjit, që, si rregull, është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe del jashtë juridiksionit kushtetues, ndaj edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike kërkuesi ka pretenduar se është në pozita jo të barabarta me shtetas të tjerë, ndërsa pozita e tij në lidhje me lirinë personale është rënduar pa një proces të rregullt ligjor. Ndërsa për cenimin e së drejtës së pronës ai ka parashtruar se për shkak të fillimit dhe vazhdimit të paligjshëm të procedimit penal, aktiviteti i tij ekonomik është pezulluar, Kolegji vlerëson se këto pretendime të kërkuesit lidhen me pretendimin tjetër të tij, atë për cenimin e lirisë personale, ndaj do të shqyrtohen në kuadër të këtij pretendimi. Për rrjedhojë, në vijim, Kolegji do të shqyrtojë pretendimin e kërkuesit për cenimin e lirisë personale në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e proporcionalitetit vetëm për masën “Arresti në shtëpi”.

B. Për cenimin e lirisë personale në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e proporcionalitetit

22. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e proporcionalitetit, pasi kufizimi i lirisë së tij për periudhën 02.02.2023 - 29.02.2024 nën masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” përbën kufizim të pajustificuar dhe joproporcional në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së. Gjykatat e zakonshme nuk kanë diskutuar për proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, duke mos treguar arsytet e duhura dhe të mjaftueshme që mbështesin vendimet e tyre, por kanë përdorur një arsytim abstrakt dhe stereotip, i cili është vlerësuar më se një herë si i papërshtatshëm nga GJEDNJ-ja. Gjykatat nuk kanë konsideruar vendimin unifikues nr. 7/2011 të Gjykatës së Lartë në lidhje me argumentimin e nevojave të sigurimit, vendimin nr. 103/2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit masa e sigurimit nuk është masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një veprë penale, por një kufizim i përkohshëm dhe shkalla e tij varet nga nevojat konkrete të hetimit, si dhe vendimin unifikues nr. 3/2002 të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit masat e sigurimit mund të caktohen edhe pa u marrë personi më parë si i pandehur, me kusht që të jetë vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet dhe për të drejtat e tij, ndërkohë që në rastin konkret, për akuzën e dytë, kërkuesit nuk i është lënë mundësia dhe koha për t’u mbrojtur në respektim të nenit 31 të Kushtetutës. Gjykatat e zakonshme nuk kanë konsideruar as nenin 49 të KP-së në lidhje me rrethanat lehtësuese në favor të kërkuesit, ndërsa në dosjen gjyqësore gjenden një sërë dokumentesh shkresore të cilat duhet të ishin analizuar dhe marrë në konsideratë për të arritur në përfundime në lidhje me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e caktimit të masës së sigurimit ndaj tij. Gjykatat e zakonshme kanë dështuar të tregojnë detyrimet

e lindura nga KEDNJ-ja, më së paku të atyre që lidhen me arsyet relevante dhe të mjaftueshme që justifikojnë masën “Arresti në shtëpi” ndaj kërkuesit, si dhe për faktet specifike dhe rrethanat personale të kërkuesit që justifikonin mbajtjen e tij nën këtë masë sigurimi.

23. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, të cilat parashikohen në mënyrë të detajuar në KPP. Neni 27, pika 2, i Kushtetutës parashikon rastet e kufizimit të lirisë personale, ndërsa shkronja “c” e kësaj dispozite kushtetuese parashikon si të tilla: ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen nga individit të një veprë penale, parandalimin e kryerjes prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, kusht i domosdoshëm (*sine qua non*) për caktimin e masës së sigurimit është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individit ka kryer një veprë penale (*neni 228, pika 1*). Ndërkohë që për sa i takon zëvendësimin të masës së sigurimit, neni 260, pika 2, i KPP-së parashikon se kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë.

25. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara

dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po kështu, Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr.18, datë 15.03.2016; nr. 8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më lart dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues, Kolegji vlerëson që pretendimet e kërkuarit për cenimin e lirisë personale të analizohen në raport me standardin kushtetues të “*dyshimit të arsyeshëm*” dhe rregullat procedurale të KPP-së për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, pra nëse gjykatat e zakonshme që nuk kanë pranuar zëvendësimin e masës së sigurimit të kërkuarit, kanë arsyetuar në lidhje me proporcionalitetin e saj.

28. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se procesi është vënë në lëvizje me kërkesën e kërkuarit për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, duke pasur dhe dakordësinë e organit të akuzës lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit personal, e cila është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë me vendimin nr. 2223, datë 28.09.2023, me arsyetimin se ishte e pabazuar në ligj dhe prova. Ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar se ndaj personit nën hetim vazhdon të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm e i mbështetur në prova në lidhje me veprën penale për të cilën ai dyshohet dhe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 9, datë 02.02.2023, janë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit të paraqitura në kërkesën objekt shqyrtimi dhe janë arsyetuar në vendimmarrjen e saj, duke e zëvendësuar masën “Arresti në burg” me masën “Arresti në shtëpi”. Po sipas gjykatës, masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” vazhdon të jetë e vetmja masë e përshtatshme për kërkuarin, pasi nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë për sa i përket faktit penal për të cilin dyshohet kërkuari, por edhe rrezikut për largimin e tij. Në arsyetimin e këtij vendimi gjykata ka mbajtur parasysh edhe vendimin unifikues nr. 7/2011.

29. Mbi ankimin e kërkuarit gjykata e apelit, me vendimin nr. 2000 (30-2023-7621), datë 01.11.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, me arsyetimin se nga momenti i caktimit të masës së sigurimit nuk ka një ndryshim të akuzës ose lehtësim të

përgjegjësisë së personit të hetuar lidhur me këtë veprë penale. Sipas gjykatës së apelit, nevojat e sigurimit vazhdojnë të jenë të njëjta dhe masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” vijon të mbetet e vetmja masë e përshtatshme për personin nën hetim në raport me rëndësinë e veprës dhe sanksionin penal të parashikuar për veprën penale konkrete

30. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-904, datë 21.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit me arsyetimin se ai nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas Gjykatës së Lartë, nga gjykata e apelit nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, dhe vendimmarrja e saj nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas asaj gjykate, ligjshmëria e vendimit nr. 2000 (30-2023-7621), datë 01.11.2023, marrë para vendimit nr. 692, datë 28.03.2024 të shkallës së dytë, që deklaroi të pafajshëm kërkuarin si dhe shuan masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, nuk mund të vlerësohet “*ex post*”, mbi bazën e fakteve të ndodhura pas këtij vendimi, por ekskluzivisht vetëm “*ex ante*”, mbi bazën e fakteve dhe të ligjit të kohës së marrjes së këtij vendimi. Sipas asaj gjykate, vendimi nr. 692, datë 28.03.2024 është vendim i ekzekutueshëm, por nuk përbën gjë të gjykuar, për sa kohë ndaj tij mund të paraqitet ankim nëpërmjet rekursit dhe si i tillë të bëhet objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë për shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

31. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuarit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat akuzohej dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë evidentuar në vendimet e tyre ekzistencën e fakteve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm se kërkuari mund të ketë kryer veprën penale dhe se nuk ekzistonin kushtet dhe kriteret për zëvendësimin e saj. Ashtu siç evidenton edhe Gjykata e Lartë, ndonëse vendimi i fajësisë është prishur dhe masa e sigurimit është shuar për shkak të kryerjes së dënimit nga kërkuari, për sa kohë vendimi i gjykatës së apelit që ka shpallur të pafajshëm kërkuarin nuk përbën gjë të gjykuar, kërkuari ruan të njëjtin status procedural. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë analizuar faktet dhe provat në ngarkim të kërkuarit në raport me kushtet dhe kriteret për kufizimin e lirisë personale, duke arsyetuar në vendimmarrjet e tyre për sa u takon pretendimeve të kërkuarit për cenimin e lirisë personale, ashtu edhe për sa u përket konkluzioneve të arritura prej saj për ekzistencën e “dyshimeve të arsyeshme”

për kufizimin e kësaj të drejte dhe për plotësimin e kushteve e kriterëve për zëvendësimin e saj. Po kështu, pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs janë analizuar dhe vlerësuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar gjetjet e saj në drejtim të të drejtave procedurale dhe kushtetuese të tij.

32. Në këto kushte, Kolegji çmon se në rastin konkret gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me proporcionalitetin e masës, duke arsyetuar edhe në drejtim të “masës së duhur”, pra nëse ajo ishte e “përshtatshme” në raport me nevojat e sigurimit. Po kështu, ato (gjykatat) në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit në rastin konkret, krahas rrezikut që diktonte dhe justifikonte vendosjen e masës së sigurimit, e kanë analizuar dhe vlerësuar atë edhe në raport me rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e lartë të veprës penale dhe pasojat e ardhura prej saj dhe pse nuk plotësoheshin kushtet dhe kriteret ligjore për zëvendësimin e saj. Për pasojë, kufizimi i lirisë personale të kërkuesit nuk rezulton të jetë në kundërshtim me nenin 27, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, nenin 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së dhe dispozitat ligjore përkatëse të KPP-së që përcaktojnë procedurat e kufizimit të kësaj lirie.

33. Po kështu, Kolegji vëren se në analizë të përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi, ato paraqiten të rregullta në formë dhe pasqyrojnë rrethanat e çështjes, shkaqet e përmbledhura të kërkesës së kërkuesit në shkallë të parë dhe ato të ankimit/rekursit në dy shkallët e tjera, duke treguar, këto të fundit, në pjesën arsyetuese edhe arsytet e mospranimit të ankimit/rekursit. Vendimet nuk rezultojnë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtje. Në pjesën arsyetuese ato i japin përgjigje kërkimit të kërkuesit për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, pasi kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e tij të ngritura në ankim dhe rekurs. Po kështu, duket se pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në unitet e harmoni me njëra-tjetrën, duke përjashtuar çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Nga ana tjetër, ndonëse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, arsyetimi i saj nuk duket të jetë i kufizuar, pasi u ka dhënë përgjigje në thelb shkaqeve të parashtruara në rekurs. Në këtë mënyrë, kolegji vlerëson se vendimet gjyqësore plotësojnë standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

34. Në përfundim të analizës së mësipërme, interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjen konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyt vetëm kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve (*shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në

çështjen në shqyrtim, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vlerëson se interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë bërë duke marrë parasysh garancitë që ofron parimi i procesit të rregullt ligjor dhe se në rastin konkret nuk shfaqen probleme në aspektin kushtetues, të tilla që do të kërkonin ndërhyrjen e saj, për rrjedhojë nuk rezulton që liria personale e kërkuarit të jetë cenuar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

35. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e proporcionalitetit është haptazi i pabazuar.

36. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.